

**Ymer Fejzullahu**  
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

**Mesut Serhat Dinc**  
Kryeshef Ekzekutiv  
**KESCO sh.a**

«KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.  
«KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.  
«KOMPANIJA KOSOVARSKA ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.

KESCO SH.A.

Nr. 17 Dt. 03.3.2023

HQ 1

**Datë:03.03.2023**

**Lënda: Komentet e Furnizuesit me Shërbim Universal në Raportin Konsultativ të ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2023**

I nderuar z. Fejzullahu,

Përmes kësaj letre, po ju dërgojmë Komentet e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) lidhur me Raportin Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për të Hyrat e Lejuara Maksimale të publikuar më 16 shkurt 2023.

FSHU kërkon nga ZRRE që të shqyrtojë çështjet e ngritura në këtë dokument përpara çdo vendimi përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2023.

Me respekt,

  
**Mesut Serhat Dinc**  
Kryeshef Ekzekutiv, KESCO sh.a



***Komentet e FSHU-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së  
për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2023***

---

## I. Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji me dt. 16 shkurt 2023 ka publikuar Raportin Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për vitin 2023. Në këtë Raport është paraqitur vlerësimi fillestar i ZRRE-së lidhur me të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2023 bazuar në Aplikimin për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2023 për FSHU të dorëzuar më datë 23 janar 2023.

FSHU-ja në vazhdim të këtij dokumenti do të shqyrtojë propozimin e të hyrave të lejuara maksimale sipas Raportit Konsultativ dhe do të prezantoj të dhënat dhe argumentet që e mbështesin propozimin e FSHU-së për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2023.

## II. Kostot e blerjes së energjisë me shumicë për vitin 2023

Gjatë vlerësimit të blerjeve të energjisë elektrike për Furnizuesin e Shërbimit Universal, ZRRE ka përdorë të dhënat nga Bilanci i aprovuar me ndryshime i energjisë elektrike për vitin 2023, pavarësisht se furnizuesi nuk është pajtuar me vlerësimin e parashikimit të konsumit, për të cilën ka paraqitur edhe argumentet e veta.

Megjithëse, ZRRE në vlerësimin e blerjeve për vitin 2023 është bazuar në konsumin e parashikuar sipas Bilancit të energjisë të aprovuar me ndryshime për vitin 2023, parashikimi i blerjeve nuk është aplikuar njëtrajtësisht me parashikimin e konsumit në baza mujore.

Marrë parasysh si më lartë, FSHU në këtë aplikim ka përdorur të dhënat e konsumit Bilancit të energjisë të aprovuar me ndryshime për vitin 2023, por ka përditësuar kostot e blerjeve sipas parashikimit mujor të konsumit.

Blerjet e energjisë	GWh	€/MWh	mil€
Sasitë e furnizuara nga KEK	4,206.6	29.56	124.3
Gjenerimi sipas skemës mbështetëse	574.8	58.78	33.8
Gjenerimi në OSSh me kontrata koncesionare	46.3	49.09	2.3
Importi	66.9	167.73	11.2
Subvencioni Vendim QRK 13/118			-24.6
Jobalancet			1.9
<b>Total sasitë e furnizuara</b>	<b>4,894.7</b>	<b>30.43</b>	<b>148.9</b>
<b>Marzha me pakicë 2.54%</b>			<b>3.78</b>
<b>Gjithsej kostot me shumicë</b>			<b>152.7</b>
<b>Konsumi sipas kategorive të konsumatorëve FSHU</b>			
Konsumatorët 35 kV	58		
Konsumatorët 10 kV	435		
Konsumatorët 0.4 kV	4,414		
<b>Total konsumi i konsumatorëve të FSHU</b>	<b>4,906</b>		

Marrë parasysh kërkesën e ZRRE-së për përditësimin e çmimeve me inflacion për BRE-të në marrëdhënie kontraktuale, FSHU në aplikimin e tij ka reflektuar ndryshimet, megjithatë gjatë raportit konsultativ është vërejtur se ZRRE nuk ka aplikuar ndryshimet. Si rezultat, FSHU në këtë aplikim ka përdorur sërish çmimin e përshtatur me inflacion për BRE-të në marrëdhënie kontraktuale me FSHU-në.

Gjithashtu FSHU në këtë aplikim ka përditësuar çmimin e importit në bazë të parashikimeve të fundit në bursat ndërkombëtare. Viteve të fundit siç jemi në dijeni bota është përballë me krizë energjetike si pasojë e rritjes enorme të çmimeve të importit. Vlerat e larta të shënuara të çmimeve kanë rezultuar me pasojë likuiditeti dhe rritje të kostove në sektorin energjetik të shumë vendeve evropiane përfshirë edhe Kosovën. Për shkak që çmimet e importit vazhdojnë të jenë të larta dhe të paqëndrueshme me qëllim që të sigurohet likuiditeti i mjaftueshëm në këtë aplikim FSHU ka përdorur çmimet e prishtme në bursat ndërkombëtare, duke aplikuar edhe kostot e kapacitetit, si kostot shtese që aplikohet në çmimin përfundimtar.

Sikurse ZRRE-ja edhe FSHU në parashikimin e blerjeve të energjisë ka marrë parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.13/118 datë 11.01.2023 në vlerë prej 24.6 milion € dhe shkëmbimet KEK-KESH. Megjithatë në aplikimin e tij FSHU ka paraqitur edhe kostot për kapacitet për energjinë nga KESH, të cilat kosto janë të domosdoshme për shfrytëzimin e plotë të kësaj energjie, në të kundërtën mos-njohja e kostove të kapacitet rrezikon sjellën e energjisë nga KESH, duke rrezikuar që kjo energji tutje të mbulohet përmes importit ditor (intraday) e cila ka kosto më të lartë dhe të panjohur në tarifa në vitin relevant.

### **III. Kostot e lejuara me pakicë**

Në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, kostot e domosdoshme të cilat mundësojnë operimin e Furnizuesit janë edhe kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX).

ZRRE me vendim nr. V\_1476\_2022 ka aprovuar vlerat hyrëse dhe shpenzimet operative (OPEX) për periudhën 2022-2024. Sipas këtij vendimi OPEX i aprovuar për vitin 2023 është 5.1 milion €.

FSHU edhe gjatë procesit të konsultimit publik për vlerat hyrëse ka kërkuar reflektim nga ZRRE për rritje të pagave marrë parasysh rritjen e çmimeve dhe inflacionin e Kosovës, e cila nuk merren në konsideratë nga ZRRE gjatë përshtatjes së inflacionit.

Sipas Agjencisë së statistikave të Kosovës norma mesatare vjetore e inflacionit për vitin 2022 ka arritur në vlerën 11.6%<sup>1</sup>. Kjo vlerë e inflacionit ka ndikuar që të rëndohet buxheti i punonjësve të kompanisë e cila gjatë vitit që po lëmë pas është përcjell me kërkesa të mëdha për rritje të pagave.

Pagat e furnizuesit në krahasim me operatorët tjerë në industrinë e ngjashme janë shumë më të vogla, ndërsa si rezultat i rritjes së numrit të madh të konsumatorëve ndër vite është rritur volumi i punëve për punonjësit e FSHU-së. Volumi i rritur i punës si dhe dallimi madh në paga në mes të punëtorëve të FSHU-së dhe punëtorëve në sektorit publik të energjisë elektrike, ka rritur lëvizjet e punëtorëve të kualifikuar dhe profesional dhe rrezikon dukshëm qëndrueshmërinë operative të FSHU-së. Në këtë kuptim rritja e pagave për punonjësit e FSHU është më se e domosdoshme në mënyrë që të pasqyrohet vlera e tyre për kompaninë duke i mbajtur ata konkurrues në tregun e energjisë elektrike.

Marrë parasysh të lartë-thënat dhe nevojat e analizuara në detaje, OPEX-i i propozuar nga FSHU-ja për të siguruar operim të qëndrueshëm dhe funksional gjatë viteve 2023 është në vlerë prej 5.71 milion €.

FSHU në këtë raport ka aplikuar normën e inflacionit prej 8.39% sipas normës së inflacionit që përdor ZRRE-ja duke u bazuar në të dhënat e *Eurostat* në përshtatjet e kostove zhvlerësimit dhe OPEX-it të aprovuar për vitin 2022.

#### **IV. Kostot e bartshme (PSTCt)**

Kostot e bartshme të FSHU-së janë kosto që përcaktohen për të licencuar të tjerë dhe të cilat duhen mbuluar nga FSHU përmes tarifave të konsumatorëve fundorë për shërbimet që këta të fundit i pranojnë.

FSHU në këtë raport ka vendosur kostot e bartshme sipas vlerësimit të ZRRE-se në raportin konsultativ.

#### **V. Përshtatjet dhe Faktori Korrigjues i të Hyrave**

ZRRE në raportin konsultativ ka vlerësuar përshtatjet për vitin 2022 në vlerë prej 39.5 milion. Në përshtatjet për vitin 2022, ZRRE nuk ka marr parasysh përshtatjet e përditësuar për vitin 2021 të cilat kanë përfshirë të gjitha kostot finale të shkaktuara gjatë vitit 2021 e të cilat nuk janë reflektuar në HLM të aprovuar për vitin 2022, marrë parasysh se ishte proces i jashtëzakonshëm dhe të dhënat e muajit dhjetor 2021 ishin preliminare.

---

<sup>1</sup> Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit, Agjencia e statistikave të Kosovës, fq.4

Në përshtatjet e përditësuara për vitin 2021, FSHU gjithashtu ka përfshirë edhe kostot për jo balanca të cilat ZRRE nuk i ka njohur si kosto të realizuara për vitin 2021 gjatë procesit për përcaktimin e HLM për vitin 2022. Siç kemi theksuar edhe gjatë procesit tarifor të vitit të kaluar, FSHU nuk mund të mbahet përgjegjës për devijimet në sistemin elektroenergjetik pasi që të njëjtat janë shkaktuar si rezultat i gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar në vend.

Kostot e shkaktuara nga jobalancat ndërlidhen me energjinë të cilën e kanë përdorur konsumatorët fundor për furnizimin dhe një barrë e tillë nuk mund t'i ngarkohet furnizuesit, veçanërisht marrë parasysh se këto kosto tashmë i janë paguar operatorit (KOSTT). Për më tepër, vetë rregulla për të hyrat e FSHU-së parasheh mbulimin e këtyre kostove dhe mos-njohjen e tyre në tarifat fundor është në kundërshtim me rregullën.

Duhet të theksohet se me 16 nëntor 2022, ZRRE përmes vendimit nr.V\_1618\_2022 i ka shqiptuar dënim me gjobë FSHU-së, duke trajtuar edhe çështjen e jobalancave. Pavarësisht mos-pajtueshmërisë në qëndrim lidhur me gjobën, meqenëse situata e krijuar ishte si rezultati gjendjes së jashtëzakonshme, ZRRE-ja ka penalizuar FSHU-në përmes gjobës së shqiptuar, andaj mos-njohja e kostove nënkupton shqiptim të dyfishtë të dënimit për të njëjtën çështje.

Marrë parasysh si më lartë, FSHU kërkon edhe njëherë që këto kosto të njihen nga ZRRE në të kundërtën përderisa një kosto e tillë e shkaktuar dhe konsumuar nga konsumatori fundor, nuk i njihet furnizuesit ashtu siç përcaktohet në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, e aprovuar nga vet ZRRE-ja, atëherë obligimet për jobalanca nuk do të mund t'i paguhen operatorit në po të njëjtën vlerë.

Duke u bazuar në të lartë-thënat, përshtatjet për vitin 2022 janë si më poshtë:

Faktori korigjues i të hyrave - KREV	Njësia	Vlera
AACat-1	mil€	372.29
ARRt-1	mil€	331.04
It	%	6.91
<b>KREV = (AACat-1 - ARRt-1)*(1+It)</b>	<b>mil€</b>	<b>44.10</b>

## VI. Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në për vitin 2023

Tabela e mëposhtme përmbledh të hyrat e lejuara maksimale të kërkuar nga FSHU-ja për vitin 2023, pas marrjes në konsideratë të të gjitha përshtatjeve të nevojshme, ashtu siç janë argumentuar më lartë.

HLM i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	Propozimi i FSHU-se 2023
<b>Parametrat e indeksimit</b>		
Norma e interesit It	%	6.91%
<b>Kostot me pakice te furnizuesit</b>		
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t)^* (1 - P_t)$	€m	5.71
Zhvlerësimi - $DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.12
<b>Kostot e bartshme</b>		
Kostot e OST	€m	22.25
Kostot e OSSh	€m	151.97
Kostot për fondin e BRE	€m	12.37
<b>Kapitali punues (WCLCt)</b>		
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$	€m	1.99
<b>Kostot për blerjen e energjisë</b>		
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	152.74
<b>Taksa për licencë</b>		
Taksa për licencë	€m	0.04
<b>Borxhi i keq (BDTA)</b>		
BDTA	%	2.2%
BDTA	€m	8.80
<b>Përshtatjet e të hyrave për FSHU</b>		
Përshtatjet e vitit 2022	€m	44.10
<b>Të hyrat e lejuara maksimale</b>	<b>€m</b>	<b>400.09</b>

Me qëllim të reflektimit të kostove të pritshme, të nevojshme për operim të sigurt të FSHU-së, nevojiten 400.09 milion €. Çdo reflektim më i ultë se kostot e kërkuara do ta rrezikoj operimin e qëndrueshëm të FSHU-së i cili për më shumë se dy vite është përballur me probleme likuiditeti si pasojë e pandemisë CODIV dhe krizës energjetike. Qëllimi i FSHU-së pa dyshim është të ofroj shërbime të një cilësie të lartë për konsumatorët e vet dhe FSHU vazhdimisht është duke punuar në këtë drejtim, andaj për të përmbushur edhe më tej qëllimin dhe objektivat e veta, FSHU-së i duhen që kostot e nevojshme për operim të lejohen nga Rregullatori.